

UDHËZIM PËR VLERËSIM

VËREJTJE: Gabimet në gramatikë duhet anashkaluar, vetëm nëse është qëllimi i detyrës kontrollimi i rregullës së caktuar gramatikore ose drejtshkrimore.

DETYRA 1: Nxënësi/nxënësj* merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Qëllimi i arkitekturës është që të sigurojë që ndërtesat të jenë të forta, të duken bukur dhe t'u përgjigjen destinimit të tyre. *(dhe përgjigje të tjera të sakta)*

DETYRA 2: është rrethuar numri 1 – Harqet me majë dhe tavanet e larta
1 pikë

DETYRA 3: nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Kanë mundur të ndërtojnë dhe dizajnojnë shumëkatëshet./Ai ka mundësuar ndërtimin e rrokaqiejve...
(dhe përgjigje të tjera të sakta)

DETYRA 4: nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Kompjuterët u ndihmojnë që ta llogarisin peshat dhe forcat e ndryshme në ndërtimtari; të ndryshojnë dizajnin nëse është e nevojshme; teknologjitë e reja mundësojnë ndërtimin e objektit/ndërtesave të formave dramatike ose futuriste.
(dhe përgjigje të tjera të sakta)

DETYRA 5: nxënësi merr **1 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë: S, P, P.

DETYRA 6: gjithsej **2 pikë** nëse nxënësi ka shkruar: *Rrëfimi mbështetet në evokimin e kujtimeve, ndërsa në këtë fragment flitet për çrrënjosjen me dhunë nga atdheu.*

Nxënësi merr **1 pikë** për vetëm pjesën e parë apo të dytë të përgjigjes së saktë.

DETYRA 7: nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar numrin 3 - *letrar-artistik*

DETYRA 8: gjithsej **2 pikë** nëse ka shkruar: *Amaneti i plakës ishte që pasardhësit e saj të kthehen në atdhe, kurse fjala amanet mund të zëvendësohet me fjalën dëshirë. (dhe përgjigje të tjera të sakta)*

Nxënësi merr **1 pikë** për vetëm pjesën e parë apo të dytë të përgjigjes së saktë

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
QERSHOR, VITI MËSIMOR 2023-2024

*Në tekstin e mëtejshëm nxënësi

DETYRA 9: është rrethuar numri 4 – kundërshtore
1 pikë

DETYRA 10: gjithsej **2 pikë:**

Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar figurën stilistike të përdorur në fjalinë e parë: antiteza

Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar figurën stilistike të përdorur në fjalinë e dytë: epiteti

DETYRA 11: është rrethuar numri 1 – Në vetën e parë
1 pikë

DETYRA 12: nxënësi merr **1 pikë** për shkrimin e fonemës së njëjtë e cila ndodhet në tri fjalët e dhëna e ajo është fonema: //

DETYRA 13: gjithsej **2 pikë** nëse ka plotësuar tabelën:

PERSONAZHI	VEPRA	AUTORI
Teli	Vilhelm Teli	Fridrih Shiler
Nita	Nita	Josip Rela
Roberti	Ne të tre	Fatos Kongoli

Nxënësi merr **1 pikë** për një titull të veprës të shkruar saktë dhe autorin e saj.

DETYRA 14: është rrethuar numri 1 – beja e dheut
1 pikë

DETYRA 15: është rrethuar numri 4 – Të gjithë më kërkuan derisa nuk më gjetën se ku isha fshehur.

1 pikë

DETYRA 16: nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar ose rrethuar fjalën nga e cila mund të kuptohet kryefjala që mungon në fjalinë e dhënë: *shkoi*

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
QERSHOR, VITI MËSIMOR 2023-2024

DETYRA 17: gjithsej **2 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë:

- A) nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar rasën e fjalës së kërkuar:
dhanore
- B) nxënësi merr **1 pikë** nëse ka bërë sqarimin e përdorimit të presjes në fjalinë e dhënë: *Presja është përdorur për të vënë në dukje fjalët në rolin e gjymtyrëve homogjene në fjalinë konkrete.*

DETYRA 18: nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar saktë me shkronja numrin:
Pesëqind e gjashtëdhjetë

DETYRA 19: gjithsej **2 pikë**:

- A) Nxënësi merr **1 pikë** nëse rrethuar ka formuar fjalën e përbërë që kërkohet: *hekurpunues*
- B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar numri 2 – *marrça*

DETYRA 20: Skema e vlerësimit të hartimit ***Para një vepre artistike.***

Vërejtje: Pranohet edhe nëse nxënësi e ka shkruar ose ka filluar të shkrua hartimin në fletën e paraparë për shkrimin e planit të hartimit.

Përmbajtja – 10 pikë

Kërkesa 1.

Nxënësi merr 1 pikë nëse shkruan vetëm se e do/nuk e do artin; se është i /e entuziazmuar/nuk është i/e entuziazmuar me veprat e artit dhe ngjashëm.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Kërkesa 2.

Nxënësi merr 1 pikë nëse shkurtimisht shkruan se si është gjetur para një vepre të artit ose ndonjë ndërtese/se si ka ardhur deri tek një libër/përse e ka shikuar një film të caktuar ose ndonjë shfaqje dhe ngjashëm.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
QERSHOR, VITI MËSIMOR 2023-2024

Gjithsej 2 pikë

Kërkesa 3.

Nxënësi merr 1 pikë nëse përshkruan shkurtimisht veprën e artit para së cilës është gjetur ose që e ka shikuar/dëgjuar apo ngjashëm.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Kërkesa 4.

Nxënësi merr 1 pikë nëse shkruan shkurtimisht ndjenjat e veta të cilat i ka ngjallur ajo vepër.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Kërkesa 5.

Nxënësi merr 1 pikë nëse shkruan përse ajo vepër i ka lënë përshtypje të veçantë.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Gjuha dhe struktura e tekstit - 8 pikë

Leksiku	Saktësia gjuhësore	Lidhshmëria	Struktura e tekstit
→ të shprehurit e qartë dhe të saktë, zgjedhja përkatëse e fjalëve, leksiku i pasur 2 pikë	<u>GRAMATIKA</u> → respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, formave gramatikore, kongruencës) 2 pikë	→ renditja e natyrshme e të dhënave të ofruara, lidhshmëria e mirë në nivelin e tekstit dhe pjesëve të tij	→ përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe formës së tekstit strukturës së tij logjike

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
QERSHOR, VITI MËSIMOR 2023-2024

<p>→ të shprehurit e qartë dhe të saktë, leksiku i varfër dhe përsëritja e shprehjeve</p> <p>pjesërisht e saktë</p> <p>1 pikë</p>	<p><u>DREJTSHKRIMI</u></p> <p>→ respektimi i normës drejtshkrimore (përdorimi i drejtë i shkronjës së madhe në fillim të fjalisë dhe i shenjave bazë të pikësimit, respektimi i rregullave për shkrimin bashkë dhe ndaras të fjalëve, si dhe për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit)</p> <p>2 pikë</p> <p>Gjithsej 4 pikë</p> <p><u>GRAMATIKA</u></p> <p>→ respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet semantike...)</p> <p>pjesërisht e saktë</p> <p>- 1 pikë</p> <p><u>DREJTSHKRIMI</u></p> <p>→ respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të vogla (gabimet e vogla në shenjat e pikësimit: presja te fjalitë e ndërmjetme, inversioni, te fjalitë bashkërenditëse dhe</p>	<p>1 pikë</p> <p>→ s' është i lidhur në nivel të tekstit dhe pjesëve të tij</p> <p>0 pikë</p>	<p>1 pikë</p>
---	---	---	----------------------

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
QERSHOR, VITI MËSIMOR 2023-2024

	<p>nënrenditëse, respektimi i rregullave për shkrimin bashkë dhe ndaras të fjalëve, si dhe për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit)</p> <p>pjesërisht e saktë - 1 pikë Gjithsej 2 pikë</p>		
--	---	--	--